



DEVELOPMENTAL DISABILITIES ADMINISTRATION (DDA)

Njoftim i Rishqyrtimit të Kualifikimit në Moshën Njëzet (20) Vjeç Notification of Age Twenty (20) Eligibility Review

EMRI DHE ADRESA E KLIENTIT

EMRI DHE ADRESA E PËRFAQËSUESIT TË KLIENTIT

PËR: NJOFTIM I RISHQYRTIMIT TË KUALIFIKIMIT NË MOSHËN NJËZET (20) VJEÇ

Tani kualifikoheni për Administratën e Pa-aftësive të Zhvillimit (DDA). Kualifikimi juaj me DDA duhet të rishqyrtohet përpara ditëlindjes tuaj të njëzetë (20-të). Informacioni që kemi mund të jetë i pamjaftueshëm që të vazhdoni kualifikimin tuaj për DDA nën një prej sëmundjeve të mëposhtme: Pa-aftësi intelektuale, paralizë cerebrale, epilepsi, autizëm ose një sëmundje tjetër neurologjike **ose** e ngjashme me pa-aftësinë intelektuale. Kemi bashkëngjitur Tabelën e dokumentacionit të kërkuar për t'ju bërë të ditur se çfarë informacion nevojitet.

Çfarë duhet të bëni?

DDA do të ketë kënaqësinë t'ju dërgojë informacionin e nevojshëm për këtë ri-vlerësim. Nëse dëshironi që DDA t'ju dërgojë informacionin, ju lutemi plotësoni formularin e bashkëngjitur të pëlqimit sa më poshtë:

1. Shkruani emrat e vendeve, siguresve të shërbimit dhe të mjediseve për të cilat kërkojmë informacion në formularin e pëlqimit. Përfshini informacionin e kontaktit për të gjithë ata të renditur në formularin e pëlqimit.
2. Nënshkruani dhe vendosni datën në formularin(ët) e përfshirë të pëlqimit, dhe
3. ktheni formularin(ët) tek DDA.

Çfarë ndodh nëse nuk i përgjigjem kësaj kërkesë?

Ju lutemi përgjigjuni sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 90 ditë përpara ditëlindjes tuaj të njëzetë (20-të). Nëse nuk marrim përgjigje nga ju deri më _____, do të rishqyrtojmë kualifikimin tuaj duke përdorur informacionin që kemi në dispozicion në dosjen tuaj të klientit. Nëse nuk ka informacion të mjaftueshëm për të konfirmuar vendimin e kualifikimit, atëherë kualifikimi juaj për DDA do të përfundojë në ditëlindjen tuaj të 20-të.

Nëse keni ndonjë pyetje, kontaktoni:

EMRI

NUMRI I TELEFONIT

ADRESA E EMAILIT

Një kopje e rregullave shtetërore që qeverisin kualifikimin (WAC 388-823) është e disponueshme sipas kërkesës ose në internet në <https://www.dshs.wa.gov/dda/consumers-and-families/eligibility>.

Të bashkëngjitura: Tabela e dokumentacionit të kërkuar
Formulari i pëlqimit (DSHS 14-012)

kopje: Dosja e klientit

Tabela e dokumentacionit të kërkuar

SËMUNDJA E PA-AFTËSISË	DIAGNOZA	DIAGNOSTIFIKUESI	TË DHËNA TË TJERA
Pa-aftësia intelektuale	Pa-aftësia intelektuale	Një psikolog i licencuar, psikolog i shkollës i çertifikuar nga Washington ose psikolog tjetër i shkollës i çertifikuar nga Organizata Kombëtare e Psikologëve të Shkollës	Raporti i plotë psikologjik që përfshin një rezultat të plotë të shkallës së inteligjencës prej më shumë se dy devijime standarte nën mesataren dhe rezultati i testimit të aftësive të adaptimit prej më shumë se dy devijime standarte nën mesataren.
Paralizë cerebrale	Paralizë cerebrale Kuadriplegia Hemiplegia Diplegia	Mjek i licencuar	Ka filluar përpara moshës 3 vjeç dhe informacion që mbështet nevojën për ndihmë fizike të drejtpërdrejtë të përditëshme në dy ose më shumë sfera (shkuarja në banjë, bërja e banjës, ngrënia, veshja, lëvizja ose komunikimi).
Epilepsia	Epilepsia ose Çrregullim i krizave	Neurolog i çertifikuar nga bordi	Diagnozë e mbështetur në historinë mjekësore dhe analiza neurologjike, konfirmimi nga mjeku ose neurologu i krizave të pakontrolluara dhe të tanishme ose të vazhdueshme dhe testi i aftësive të adaptimit që tregon kufizime të konsiderueshme në funksionimin adaptues prej dy ose më shumë devijime standarte nën mesataren.
Autizëm (sipas DSM-IV)	Autizëm ose çrregullim i autizmit sipas 299.00 në DSM-IV-TR	Një psikolog i licencuar, infermiere praktike e regjistruar e përparuar (ARNP) pranë një qendre të autizmit ose të zhvillimit ose një Bordi të çertifikuar: Neurolog, psikiatër ose pediatër të zhvillimit dhe sjelljes	Vlerësim i plotë për DSM-IV që përmbush të gjitha kriteret e diagnostifikimit, prova të funksionimit të vonuar ose jo-normal përpara moshës 3 vjeç në aftësi sociale, të gjuhës, të komunikimit ose të lojës simbolike ose të imagjinatës dhe testi i aftësive të adaptimit që tregon kufizime të konsiderueshme në funksionimin adaptues prej dy ose më shumë devijime standarte nën mesataren.
Çrregullimi i spektrit të autizmit (sipas DSM-V)	Çrregullimi i spektrit të autizmit 299.00 sipas DSM-5 përfshirë nivelet 2 ose 3 të seriozitetit në të dyja kolonat	Një psikolog i licencuar, infermiere praktike e regjistruar e përparuar (ARNP) pranë një qendre të autizmit ose të zhvillimit ose një Bordi të çertifikuar Neurolog, psikiatër ose pediatër të zhvillimit dhe sjelljes	Vlerësim i plotë për DSM-V që përmbush të gjitha kriteret e diagnostifikimit, prova të funksionimit të vonuar ose jo-normal përpara moshës 3 vjeç në aftësi sociale, të gjuhës, të komunikimit ose të lojës simbolike ose të imagjinatës, testi i aftësive të adaptimit që tregon kufizime të konsiderueshme në funksionimin adaptues prej dy ose më shumë devijime standarte nën mesatare dhe FSIQ të një devijimi standart ose më shumë nën mesataren – ose – përmbush të gjitha kriteret për Çrregullimi e autizmit 299.00 sipas DSM-IV.
Një sëmundje tjetër neurologjike ose e ngjashme me pa-aftësinë intelektuale	Çrregullim neurologjik ose i kromozomeve që dihet të shkaktojë mungesa të inteligjencës dhe aftësive të adaptimit	Mjek i licencuar	Një rezultat i plotë i shkallës së inteligjencës prej më shumë se 1.5 devijime standarte nën mesataren dhe testim i aftësive të adaptimit që tregon kufizime të konsiderueshme në funksionimin adaptues prej dy ose më shumë devijime standarte nën mesataren.

Vini re: Ky formular është vetëm një udhëzues i përgjithshëm dhe DDA mund të kërkojë informacion ose vlerësime shtesë. Ky dokumentacion është hapi i parë në përcaktimin e kualifikimit. Kualifikimi i DDA-së përcaktohet sipas Kapitullit 388-823 WAC.